



Tel: +381 0390 326 812;  
E-mail: [medica.gjakova@hotmail.com](mailto:medica.gjakova@hotmail.com)

***Shoqata e Grave Medica Gjakova  
Women's Association Medica Gjakova***

***Raporti Përfundimtar për Projektin me Nr.: 2009.1577.7***

***“Themelimi I kooperatives së grave për sigurimin dhe arrijtjen e standardeve jetësore bazike të grave në Kosovë – me theks të posaqëm të grave të veja dhe të të mbijetuarave të dhunes gjatë luftës”***

***Periudha raportuese: 01.04. 2011 - 28. 02. 2013***

***Organizata implementuese: Shoqata e Grave Medica Gjakova***

***Mars 2013***

***HYRJE***

*Shoqata e Grave Medica Gjakova (mgj) është një OJQ locale, e pavarur dhe jo-fitimprurese me misionin e përmiresimit të gjendjes shëndetësore mentale dhe fizike të grave të mbijetuara të dhunes, si dhe ndikimin në politikat sociale në perkrahjen e mirëqenies së grave dhe integritet të tyre në shoqëri. MGJ gjithashtu promovon respektimin e të drejtave të njeriut në përgjithësi, me theks të veçantë të të drejtave të grave pa diskriminim etnik, fetar apo racor.*

***Përmbajtja:***

- Fjala hyrëse e drejtoreshes*** **2**
- Përmbledhje e projektit*** **3**
- Tabela e përfitueseve të projektit*** **4**
- Objektivat dhe aktivitetet*** **6**
- Sfidat dhe vështirësitë*** **12**



**Fjala Hyrëse e Drejtoreshes së MGJPo** takohemi sot për të dokumentuar zhvillimet dhe aktivitetet tona gjatë kësaj periudhe jo dhe aq të lehtë për ne. Aktivitetet dhe të arriturat e MGJ nuk do të kishin mundur të realizoheshin pa përkushtimin këmbëngulës të aktivisteve të shoqates, si dhe pa përkrahjen e donatorve tanë të vazhdueshëm: Qeverinë Gjermane për Bashkepunim dhe Zhvillim (BMZ) dhe medica mondiale e.V nga Kelni / Gjermani.

Prandaj, në emër të shoqates, falenderoj donatorët, aktivistet dhe te gjithë të tjerët që nuk kemi mundësi t'i permendim në këtë raport për përkrahjen gjatë rrugëtimin tonë të ri.

MGJ kaloi 2 vite veprimtarie që nga themelimi në vitin 2011.

Përkundër vështirësive me të cilat u fallafaquan aktivistet e shoqates gjatë kesaj periudhe që nga ndarja e një pjese të stafit profesional nga shoqata Medica Kosova, ato/a arrijtën që të themelojnë shoqaten e re, me ç'rast pasuan aktivitetet për vazhdimin e implementimit të projektit: "Themelimi i kooperative së grave me qellim të sigurimit dhe krijimit të standardeve bazike jetësore të grave në Kosovë – në veqanti të vejat dhe të mbijetuarat e dhunes gjatë luftes"

Ne vazhduam përpjekjet tona për përmirësimin e gjendjes shëndetësore mendore dhe fizike të grave të traumatizuara gjatë luftes në Kosovë dhe pas saj. Në të njejtën kohë, shoqata vazhdon të promovoj të drejtat e grave dhe integrimin e tyre në çdo sferë të jetes. Nuk kanë munguar as përpjekjet e shoqates që në bashkëpunim me shoqata tjera aktive në Kosove të ndikoj në përmirësimin e statusit juridik të viktimave të dhunes sexuelle, dhe integrimin e tyre në Ligjin mbi Vivtimat Civile të Luftes në Kosovë. Prandaj MGJ është bërë qendër referuese e grave të traumatizuara. Kjo është një punë mjaft e ndjeshme dhe kërkon një përkushtim dhe profesionalizëm të personelit shëndetësor psikosocial dhe gjinekologjik.

Një sukses domethënës për shoqaten gjatë kesaj periudhe është edhe sigurimi i 3 granteve për 3 projekte afatshkurta nga donatorë ndërkombtar të vendosur në Kosovë, të cilat projekte do të na mundësojnë vazhdimin e perkrahjes për përfitueset tona si dhe përpjekjet tona për sigurimin e fondeve për një projekt më afatgjatë gjatë vitit në vijim.

Ky raport për periudhen Mars 2011- Shkurt 2013 dokumenton zhvillimet, aktivitetet dhe sfidat tona gjatë kësaj periudhe.

Znj. Selamet Peni – Drejtoreshë



***Certifikata e themelimit të Kooperativës bujqësore e grave femere Duart e Dardanes, dhe hapja e shitores si njësi e parë punuese e saj***

## **1. Përmbledhje**

Qëllimi kryesor I projektit është zvoglimi I nivelit të varfërisë shoqërore të 400 grave dhe anëtarëve të familjeve të tyre në komunat e Gjakoves dhe Deqanit; përmirësimi i mirëqenjes psikologjike të grave dhe integrimi I tyre në shoqëri dhe më gjërë. Gratë janë fuqizuar dhe kanë themeluar njësitë punuese të quajtura grupet vetë-përkrahëse, dhe në të njëjtën kohë shoqëria ka përfituar nga përmirësimi I infrastruktures bujqësore. Në përgjithësi projekti ka përkrahur promovimin e prodhimeve bujqësore në Kosovë duke rritur kërkesat e tregut për produkte vendore.

Për të arrijtur qëllimin, shoqata e grave Medica Gjakova ka arrijtur qëllimet specifike si në vijim:

**1. Një qumshstore për përpunimin e qumshetit të mbledhur nga 120 gra femere është ngritur në bazë të standardve të BE e dizajnuar për prodhime të qumshetit**

**2. Me qëllim të promovimit dhe shitjes së mjaltes dhe prodhimeve të saj në nivel local dhe regional është hapur një pikë grumbulluese e mjaltes kualitative, si dhe është rritë niveli i njohurive tekniko/biznesore të grave të përfshira në këtë process.**

**3. Gratë nga qyteti janë pjesë e zingjirit furnizues dhe i shesin prodhimet e grave të zonave rurale në shitore e marrë me qera në qendër të qytetit , dhe në këtë mënyrë promovohet shitja e prodhimeve bujqësore vendore dhe janë ngritur aftësitë biznesore të grave të grupit të qëllimit.**

**4. Nëpërmjet këshillimeve grupore psikosociale dhe juridike grupi i qëllimit është psikologjikisht i qëndrueshëm dhe i fuqizuar për të marrë përsipër përgjegjësinë për prodhimin dhe promovimin e produkteve të tyre, si dhe për zbatimin e të drejtave të tyre ligjore lidhur me pronësinë dhe të drejtat e tyre ligjore civile.**

**5. Gratë femere ndikojnë në zhvillimin e bujqësisë ne rajonin e tyre dhe forcojnë rritizimin me organizata tjera të fermereve në dhe jashtë Kosovës, duke luajtur rol inovativ në përmirësimin e politikave publike në nivel local dhe kombëtar**

Qumshtorja është finalizuar nga Medica Kosova (MK), ndërsa ngritja e pikës grumbulluese të mjaltes siq është paraparë me projekt është penguar nga prodhimet e pamjaftueshme të mjaltes nga gratë, meqenëse një numër I madh bletësh kanë vdekur si rezultat i përhapjes së një sëmundje në rajon.

Megjithatë, bazuar në sasinë e mbledhur të mjaltes nga disa gra të suksesshme, dhe pas përkrahjes së tyre duke iu dhuruar disa bletë shtesë, një lokal në qendër të Gjakovës është marrë me qera, dhe i njëjti pëpos grumbullimit të mjaltes është shfrytëzuar edhe për organizimin e trajnimeve për 7 gra me qëllim që si grup të punojnë në përpunimin e produkteve të mjaltes (krema kozmetike, sapuna, qira etj).

Gjatë periudhës raportuese, Medica Gjakova ka përkrahur në total 406 gra nga 13 fshatra të ndryshme, si dhe gra nga qyteti. Nga ky numer, 376 gra janë përfituese të përkrahjes me séance grimore psikosociale dhe shëndetësore. 46 gra - anëtare të grupeve psikosociale janë përfituese të reja në projekt. 24 grave të dalura nga grupet iu janë ofruar gjithashtu këshillime individuale psikosociale, ndërsa 352 grave iu janë ofruar séance grimore shëndetësore psikosociale dhe gjinekologjike. Vetëm 20 grave – anëtare të 3 grupeve të reja të themeluara në Rahavec iu janë ofruar vizita gjinekologjike në ambulanca e shoqatës HAREJA në bazë të marrëveshtjes së mirëkuptimit në mes të dy shoqatave.

10 gra janë referuar në OJQ tjera lokale të cilat ofrojnë këshilla ligjore mbi të drejtat e grave, apo në institucione të ndryshme për sigurimin e dokumenteve të ndryshme për vete apo për fëmijët e tyre. 70 gra janë përkrahur me këshillime individuale psikosociale, dhe të njëjtat vazhdojnë të përkrahen që nga pas lufta, por vetëm kohë pas kohe, ose kurdoherë që kanë flashbeke nga problemet në jetën e përditshme, ndërsa 46 raste tjera individuale janë kliente të dalura nga grupet.

**Tabela 1. Përfitueset e Projektit të përkrahura nga MGJ**

Grupet e grave të përkrahura nga MGJ	Vendi dhe numri i grupeve	Forma e përkrahjes	Anëtarët
1	Dobrixhe (1)	11 gra të përkrahura me nga 1 lopë ose viq, dhe 3 kliente të reja të përkrahura me këshillime psikosociale.	14
2	Hereq (1) Aktivitete Bujqësore	8 me aktivitete bujqësore	8
3	Rracaj (1)	11 gra të përkrahura me nga 1 lopë ose viq	11
4	Shishmon (2)	5 gra të përkrahura me bletë, dhe 7 me këshillime psikosociale (kliente të reja)	12
5	Korenica I (3)	20 gra të përkrahura me nga 1 lopë ose viq, dhe 10 kliente të reja të përkrahura me këshillime psikosociale.	30
6	Korenica II (1)	10 gra të përkrahura me nga 1 lopë	10
7	Krelan (2)	15 gra të përkrahura me nga një lope, dhe 6 gra të përkrahura me këshillime psikosociale. (kliente të reja)	21
8	Dobrosh (1)	10 gra të përkrahura me nga një lopë ose viq, dhe 4 gra me këshillime psikosociale	14
9	Jahoc (1)	3 gra të përkrahura me nga një lopë, dhe 7 me këshillime psikosociale (kliente të reja)	10

10	Gjakova (1)	5 gra të përkrahura me nga një lopë, dhe 1 me këshilla psikosociale (kliente e re)	6
11	Fortesa (1)	6 gra të përkrahura me këshillime psikosociale (kliente të reja)	6
12	Krushe (1)	5 gra të përkrahura me këshillime psikosociale (kliente të reja)	5
Kliente të reja që iu janë bashkangjitur grupeve të grave, të cilave iu janë ofruar vetëm këshillime grupore psikosociale.	Të gjitha vendet e cekura më lartë (qyteti I Gjakovës dhe fshatrat)	Përkrahje psikosociale grupore.	46
13	Rahavec (3)	Seanca grupore educative shendetësore gjinekologjike	20
Numri I përgjithshëm I grave në punë me grupe		Seanca grupore shendetësore psikosociale dhe gjinekologjike	372
Kliente individuale	Gra të dalura nga grupet e grave	Këshillime psikosociale individuale	24
	Kliente individuale nga puna me projektet e përparshme.	Këshillime psikosociale individuale	24
	Gra të referuara dhe/ose të shoqëruara në institucione dhe OJQ tjera.	Këshillime juridike dhe nevoja të tjera.	10
Numri I përgjithshëm I klienteve individuale.			34

#### Numri I përgjithshëm I përfitueseve: 406

Por numri I përgjithshëm i përfitueseve direkte dhe indirekte në këtë project është përafërsisht t **4000**. Bazuar në traditat vendore, familjet Kosovare në të shumtën e rasteve jetojnë në familje të mëdha së bashku me fëmijët, anëtarët e familjeve të bashkëshortëve et., prandaj kjo është shifra e përafërt e përfitueseve direkte dhe indirekte.

Si rezultat I ndarjes nga organizata e përparshme në vitin 2011, gratë – anëtare të DeD gjithashtu u ndanë duke iu bashkuar organizatës së posathemeluar nga grupi I grave profesionale Duke zhvilluar aktivitete rretizuese të suksesshme për gratë dhe me gratë fermere gjatë takimeve të të përbashkëta, dhe në 2012 gratë themeluan kooperativën bujqësore të grave fermere: Duart e Dardanes”.

Gjatë periudhës implementuese të projektit, në bashkëpunim me Drejtorinë për Bujqësi dhe Pylltari në nivel local, në mesin e grave fermere një kliente e MGJ është zgjedhur fermere e suksesshme në rajonin e Gjakoves.

Gjatë gjithë periudhës implementuese janë zhvilluar aktivitete lobizuese, ndërsa posaqërisht gjatë vitit 2012 janë bërë përpjekje për gjetjen e mundësive për arrijtjen e qëndrueshmerisë së organizates. Drejtoresha dhe anëtarët e grupit udhëheqës kanë takuar donator vendor dhe ndërkombëtar të vendosur ne Kosovë. Prandaj MGJ ka dorëzuar disa projektpropozime në disa Ambasada dhe donator

tjerë, dhe ka fituar fonde për 3 projekte afatshurtëra port ë cilat kanë mundësuar qëndrueshmërine e organizates.

Pjesëmarrja e Drejtoreshes dhe Koordinatorës së sektorit Psikosocial në takimet e rregullta të Grupit Koordinues të shoqërisë civile në nivel local me qëllim të koordinimit të formave të përkrahjes së grave të mbijetuara të dhunës gjatë luftes për të fituar statusin e beneficuar të grave të mbijetuara të luftes. Për këtë qëllim, shoqëria civile ka punuar në vazhdimësi në pregaditjen e shtegut për shtytjen e autoriteteve qeveritare të amandamentojnë Ligjin e Viktimave Civile të Luftes në Kosovë duke I future edhe të mbijetuarat në të njejtin Ligj. Këta janë hapat e parë të ndërmarra nga shoqëria civile, ndërsa nevojitet një angazhim edhe më I madh në të ardhmen.

Si anëtare e RRGK, personeli I MGJ dhe disa kliente kanë marrë iu janë bashkangjitur protestës kombtare të organizuar me 8 Mars, me kërkesat për integrimin ligjor të të mbijetuarave të dhunës dhe për njohjen e statusit të tyre public. Gjatë vt 2011 promov imi I të drejtave të grave në nivel local dhe kombëtar duke realizuar intervista ne media të ndryshme si në: “Radio Gjakova”; Radio Kosova dhe “TV Syri Vision”. Puna me media është vazhduar me botime të artikujve në KOHa Ditore dhe Gazetën e rregullt mujore të komunes. Gjithashtu në pjesën e fundit të vitit 2012 është organizuar transmetimi I hapjes së dyqanit të cooperatives DeD ne TV Syri.



***Drejtoresha e DeD dhe shitësjaintervistohen nga TV SYRI VISION dhe KOHA DITORE***

Stafi professional – këshillueset psikosociale kanë dhënë intervista për nevojat e hulumtimit – Shërimi I Shpirtit: Riparimi I gjendjes së të mbijetuarave të dhunes seksuale gjatë konfliktit në Kosovë” – I pregaditur për Zyrën e Komisionerit të Lartë të të Drejtave të Njeriut.

Bashkëpunimi I MGJ me shoqata tjera locale, në veqanti me Grupin e Grave Asambleiste të Komunes së Gjakoves me qëllim të nxitjes së autoriteëve komunale në përkrahjen e grave të zonave rurale. MGJ ka përkrahur Grupin e Grave Asambleiste në organizimin e grupeve të grave në fsahtra të ndryshme të Gjakoves me qëllim të adresimit të nevojave të tyre.

Përfaqësuesit e KFOR-it Gjerman vizituan MGJ hde dhuruan një UltraZË dhe një shtratë gjinekologjik për ofrimin e vizitave primare gjinekologjike në ambulancën stacionare. Shoqata po përpiqet të gjejë fonde shtesë për kompletimin dhe funksionalizimin e ambulancës për nevojat e klienteve.

### **Implementimi I Projektit Objektivat dhe aktivitetet**

Qëllimi kryesor është zvoglimi I varfërisë sociale të më së 400 grave dhe të anëtarëve të familjeve të tyre ne komunat e Gjakoves, Deqanit dhe Rahavecit; përmirësimi I mirëqenjes psikosociale të grave dhe integrimi I tyre në komunitet dhe më gjërë. Gratë janë fuqizuar të themelojnë njësitë e tyre vetë-përkrahëse , dhe në të njejtën kohë komuniteti do të përfitoj nga përmirësimi I strukturave bujqësore.

Projekti në përgjithësi do të promovon prodhimet bujqësore në Kosovë dhe në të njejtën kohë të rritë kërkesen për tregun e prodhimeve vendore..

MGJ ka ndërmarrë disa masa se si t'1 qaset arrijtjes së qëllimeve specifike për përmirësimin e mirëqenjes së grave dhe integritimit të tyre shoqëror.

***Qëllimi 1: Një qumshtore për përpunimin e qumshtit të mbledhur nga 120 gra fermare është ngritur në bazë të standardve të BE e dizajnuar për prodhime të qumshtit***

Ky objektivi është finalizuar gjatë kohës kur stafi profesional i MGJ punonte në Medica Kosovë (MK). Raporti është kryer nga MK.

***Qëllimi 2: Me qëllim të promovimit dhe shitjes së mjaltës dhe prodhimeve të saj në nivel lokal dhe regional është hapur një pikë grumbulluese e mjaltës kualitative, si dhe është rritë niveli i njohurive tekniko/biznesore të grave të përfshira në këtë proces.***

**Aktivitetet dhe indikatorët:**

**2.1 Themelimi i një pike grumbulluese të mjaltës.**

Pika grumbulluese e mjaltës është hapur në Shtator të 2012-es. Si u përmend më lartë përfitueset e MGJ kanë mbledhur një sasi të vogël të mjaltës meqenëse një numër i madh bletësh kanë vdekur si pasojë e një sëmundje të bletëve. Një hapësirë me kushte shumë të mira higjienike është marrë me qera, e cila është përdorur për magazinimin e mjaltës dhe organizimin e trajnimeve për gratë e grupeve të bletëve.

**2.2 Është përmirësuar gjendja shëndetësore e prodhimeve të mjaltës dhe magazinimit të saj.**

Kushtet higjienike të mjaltës janë përmirësuar (prodhimi dhe magazinimi) me mbledhje dhe mirëmbajtje profesionale. Gratë e grupit të bletëve në Shishman janë pajisur me nga një kazan për grumbullimin e mjaltës dhe me blete shtesë, por mjaltja do të mbledhet gjatë sezonës së ardhshme. Mjaltja e mbledhur do të ruhet në kushte të mira higjienike gjerë në momentin kur të shitet. Analiza e kualitetit të mjaltës është bërë nga gratë e Tirolit para ndarjes nga MK, dhe ka rezultuar e pa-kontaminuar. Analizat në Kosovë nuk janë bërë pasi kushtojnë shtrenjtë, dhe gratë nuk kanë mundësi të paguajnë.

6 gra së bashku, apo grupi i grave të Shishmonit / Komuna e Gjakovës kanë sjellë 750 kg mjaltë për ta shitur në shitore. Shumë bletë kanë vdekur, dhe grupi i grave të bletëve nga fshati Irzniq /komuna e Deqanit kanë qëndruar me MK.

**2.3 Pjesëmarrja e grave në trajnimin për produktet e mjaltës.**

MGJ ka angazhuar një grua eksperte –trajnuese për produktet e mjaltës, dhe 7 gra kultivuese të bletëve nga fshati Shishmon, dhe nga Jahoci kanë ndjekur trajnimin për punimin e qirinjëvë, sapunave, kremave kozmetice, prepolisit etj. Pasi të mbledhin sasi më të madhe të mjaltës, gratë janë në gjendje të prodhojnë produktë shtesë të mjaltës. Gjer në arrijtjen në këtë pikë, ato do ta shesin mjaltën.



***Trajnuesja demonstroi punimin e produkteve të mjaltës***

## **2.4 Grupi i grave të kultivimit të bletëvë kanë zgjedhur një grua për të punuar në pikën grumbulluese të mjaltes.**

Vetëm një grua është përzgjedhur meqenëse sasia e grumbulluar e mjaltes nuk ka qenë e mjaftueshme. Gjatë vitëve të ardhshme kur gratë të mbledhin më shumë sasi do rekrutohet edhe ndonjë hgrua tjetër sipas nevojës. Përzgjedhja e është bërë nga gratë e grupit në bashkëpunim me keshilluesen e tyre. E njejtja grua është angazhuar edhe në paketimin e mjaltes. Gratë kanë përdorur tegulla të qelqta 800 gr, por jo pako të vogla plastike si ishte paraparë pasi që makina për këtë lloj paketimi kushton shumë shtrenjtë. Një arsye tjetër për të mos bërë paketimin në pako të vogla plastike është edhe ndërrimi i opinionit të popullatës që mendojnë se ky lloj paketimi nuk është i shëndetshëm, dhe restorantet po shërbejnë mjalten në enë të vogla të qelqta në vend të plastikave.

## **2.5 Gratë kanë magazinuar dhe e kanë shitur mjalten në shitore**

7 gra të grupit për kultivimin e bletëvë magazinuan dhe shitën 750 kg mjalte në shitoren e cooperatives së grave. Konsumatorëve ju ka pëlqyer mjalta aq shumë sa që kërkesat kanë vazhduar edhe pas shitjes së saj. Mjalta është shitur 6 € një tjegull e qelqtë, dhe sejcila prej tyre kanë fituar përafërsisht 630 – 650 €. MGJ do të përpiqet t'i përkrahë grupin e grave me më shumë bletë në të ardhmen në projektet për regjenerim të të ardhurave për gratë.

***Qëllimi 3: Gratë nga qyteti janë pjesë e zingjirit furnizues dhe i shesin prodhimet e grave të zonave rurale në shitore e marrë me qera në qendër të qytetit, dhe në këtë mënyrë promovohet shitja e prodhimeve bujqësore vendore dhe janë ngritur aftësitë biznesore të grave të grupit të qëllimit.***

### **3.1 Hapja e një shitoreje në qytet ku gratë shesin prodhimet e tyre.**

Pas themelimit të cooperatives së grave fermere, gratë e përkrahura nga personeli administrative dhe profesional i MGJ filluan me përzgjedhjen e 2 grave për të shitur prodhimet në shitore, si dhe me porositjen e pajisjeve të nevojshme për të. Shitorja u mor me qera për 6 muaj dhe u përkrahë me projektin ekzistues, por pas kësaj periudhe gratë vazhduan vet. Shitorja është njësi e parë punuese në kuadër të cooperatives, dhe janë respektuar të gjitha kërkesat ligjore për hapjen e saj.

### **3.2 Hapja e tenderit dhe mbledhja e ofertave për blerjen e automobilit / pick-up dhe pajisjeve tjera të nevojshme.**

Sigurimi i automjetit dhe pajisjeve të tjera është bërë sipas Ligjeve egzistuese në Kosovë, dhe në bazë të marrëveshtjes me donatorët. Janë mbajtur takimet me drejtoreshen dhe anëtarët tjera të kooperativës të cilat janë njohtuar me procedurat e pajisjes së shitorës (hapjen e tenderëve për automobile dhe mbledhjen e ofertave).

Shitorja është hapur dt 18 Tetor 2012 me organizimin e një ceremonije të hapjes. Një numër i madh i përfaqësuesve të OJQ-ve dhe institucioneve locale dhe kombëtare morrën pjesë në ceremony dhe u fascionuan me guximin e grave të kooperativës për veprimin e ndërmarrë. Përfaqësueset e OJQ-ve nga vende të ndryshme të Kosovës shprehën interesim për të ndarë përvojat e tyre me MGJ, prandaj pas ceremonisë MGJ organizoi një takim për të diskutuar për përvojat në mes grave.

### **3.3 90 gra të gatshme të furnizojnë dyqanin me prodhimet e tyre bujqësore.**

Edhe pse 12 gra kanë pranuar të bëhen aksionare të cooperatives, 90 gra në total e furnizojnë shitoren me prodhime bujqësore. Ato zakonisht e furnizojnë shitoren me qumësht të freskët dhe me prodhime të tjera qumështore; me fruta; perime; prodhime shtëpijake të kuzhines si: flija, baklava te j



***Prodhime të kuzhinës vendore***



### 3.4 Ofrimi i trajnimeve në biznes dhe marketing për gratë fermere

Adhepse janë planifikuar të ndjekin trajnimet në fljalë 14 gra, në fakt 30 gra treguan interesim për të ndjekur trajnimet për: palni i biznesit; lidhshmëri; dhe marketing. Të trajnuarat kanë marrë certifikatat përkatëse.



*Gratë janë në gjendje të shesin dhe reklamojnë produktet e tyre*



Gratë që e udhëheqin shitoren kanë kontaktuar me restorante të ndryshme dhe kanë bërë 4 marreveshje gojore me supermarket që rregullisht të ju dërgojnë prodhime.

***Qëllimi 4. Nëpërmjet këshillimeve grupore psikosociale dhe juridike grupi i qëllimit është psikologjikisht i qëndrueshëm dhe i fuqizuar për të marrë përsipër përgjegjësinë për prodhimin dhe promovimin e produkteve të tyre, si dhe për zbatimin e të drejtave të tyre ligjore lidhur me pronësinë dhe të drejtat e tyre ligjore civile.***

#### 4.1 Përkrahja psikosociale – këshillime grupore dhe individuale

Gjatë periudhës raportuese, MGJ ofroi këshillime psikosociale për 18 grupe të grave nga 13 fshatra të ndryshme të komunave të Gjakovës dhe Deqanit. Grave të grupeve iu janë ofruar nga 2 seanca grupore në muaj në lokalet e shoqatës ose nëpër fshatra. 8 grupe të grave që i janë bashkuar MGJ pas ndarjes nga MK kanë vazhduar të përkrahen përsëri. Por, gjatë periudhës së shtatë për projektin, këshillueset arritën të formojnë edhe 10 grupe të reja. Ato janë: Shishmon; Fortesë; Krushe; Jahoc; Korenicë; Koloni – një lagje e qytetit të Gjakovës e banuar kryesisht me komunitetet RAE, si dhe një grup në Rahavec.



Tri grupeve të grave në Rahavec iu janë ofruar vetëm séance grupore shëndetësore, pasi që në mesin e tyre ka pjesëtare të komunitetit RAE, dhe pas ofrimit të vizitave gjinekologjike ato kanë kërkuar gjithashtu dhe séance grupore educative shëndetësore.

Shumë gra pjesëmarrëse të seancave grupore psikosociale kanë cfaqur shenja të përjetimit të dhunës seksuale gjatë luftës. Por ato konsiderohen si raste të dyshimta gjerë në momentin kur ato të flasin haptas për ngjarjen traumatike.

Gjatë vitit 2011, seancat psikosociale me grupet e vjetra janë organizuar kryesisht në lokalet e shoqatës. Gjatë vitit 2012, këshillueset kanë arritur që të takohen në séance të përbashkëta të grave udhëheqëse të grupeve të vjetra dhe të reja. Këto séance të përbashkëta kanë ndihmuar udhëheqëseve të grupeve të reja të njihen me përvojat e grave nga grupet e vjetra të fituara gjatë periudhës implementuese të projektit. Anëtarët e grupeve të vjetra dhe disa nga grupet e reja janë motivuar për pjesëmarrje në trajnimet për biznes dhe marketing.

Temat e trajtuara në seancat grupore psikosociale përfshijnë kryesisht teknikat e zhvillimit të mekanizmave përballues me traumën që ka lidhje me dhunën seksuale. Ato fokusohen kryesisht në qështjet më të rëndësishme për procesin e zisë dhe përshtatjes. Temat ndërlidhen me identifikimin dhe perceptimin; ciklin e dhunës dhe pasojat; procesin e zisë; gjendja emocionale; nevojat dhe resurset; etj.

Ndërsa seancat shëndetësore gjinakologjike trajtonin kryesisht qështjet shëndetësore: kushtet elementare të higjienës personale; martesat e hershme dhe shtatëzaninë në moshë të reja, veqanërisht te komunitetet RAE; karcinomat e qafës së mitrës dhe të gjirit. Seancat e përbashkëta psikosociale kanë



përfshi gjithashtu dhe temat mbi barazinë gjinore dhe vakumin e komunikimit në mes të gjeneratave. Sfida më e madhe me grupet e rja ishte kur ndonjëhere gjatë seancave është diskutuar qështja e dhunës seksuale dhe se si anëtarët tjerë të familjes mund të përkrahin të mbijetuarat e dhunës seksuale, edhe pse diskutimet zhvilloheshin në vetën e tretë.

Pas seancave grupe disa klienteve iu janë ofruar edhe séance keshilluese psikosociale individuale. Ato janë mbajtur në lokalet e shoqatës ose në shtëpitë e klienteve. Përveq një numri të klienteve të përpame individuale të cilave iu janë ofruar këshillime të

**Përkrahja individuale psikosociale** kohëpaskohshme psikosociale sipas nevojës, 46 grave të tjera që kanë dal nga grupet iu janë ofruar gjithashtu séance individuale psikosociale.

#### 4.2 Ofrimi I seancave grupe shëndetësore gjinekologjike dhe vizitat dhe këshillimet individuale gjinekologjike



##### **Seancë grupe educative gjinekologjike dhe vizitë primare**

Grave përfituese të shërbimeve të shoqatës MGJ gjithashtu iu janë ofruar séance grupe educative shëndetësore dhe këshillime shëndetësorë. Me 3 grupe të grave në Rahavec janë realizuar temat: higjiena primare shëndetësore; planifikim familjaër; martesat e hershme dhe pasojat e shtatëzanisë në moshë të re; etj. Këto grupe kanë në përbërje gra të komuniteteve RAE gjithashtu.

#### **Qëllimi 5. Gratë fermere ndikojnë në zhvillimin bujqësor në rajon dhe forcojnë rrjetizimin me organizata tjera të fermereve në Kosovë dhe jashtë saj, duke lozur një rol inovativ në përmirësimin e politikave publike në nivel local dhe kombëtar.**

Pas ndarjes së një pjese të personelit nga MK, Medica Gjakova kishte synonte të bëhej një shoqatë e pavarur e fuqishme, kështu që aktivisht u angazhua në procesin e rrjetizimit me organizata locale dhe kombëtare me qëllim që të zhvillonte takime për shkëmbim përvojash të grave fermere të cooperatives Duart e Dardanes dhe grave që punonin në kooperativa tjera bujqësore në nivel local dhe regional.



**Klientet e MGJ vizitojnë OIQ-në në Mitrovicë**



**Personeli i MGJ shkëmbejnë përvojat me personelin e OIQ-ve të tjera**

Për këtë qëllim, është organizuar një vizitë studimore e grave fermere DeD në kooperativa bujqësore në Shqipëri. Gratë fermere janë të vetëdijshme për rëndësinë e trajnimeve në biznes dhe marketing nëse duan një kooperativë të suksesshme.



*Gratë fermere vizitojnë Kooperativën Bujqësore Agro Koni në Shqipëri*

Drejtoresha e MGJ dhe Drejtoresha e kooperativës së grave fermere DeD kanë kontaktuar përfaqësuesit e OJQ-së Inisiativa Kosovare për Komunitete (IKC) që i përkrahë përfituesit/et me aktivitete për regjenerim ekonomik ku shkëmbyen onformata mbi përvojën e grave fermere. Gratë fermere të DeD treguan interesim që t'i vizitojnë.

Gratë e grupeve përfituese të bletëve kanë marrë pjesë dhe kanë shitur prodhimin e mjaltës në Panairin e Mjaltës të organizuar nga Drejtorija për Bujqësi dhe Pylltari në Komunën e Gjakovës, si dhe në panairin tjetër të organizuar nga OJQ FLORA.



*Një konsumator blenë mjaltë në panair*



*Gratë fermere promovojnë mjaltën në panair*

Pjesëmarrja e përfaqësueseve të MGJ në takimet e rregullta të RRGK, në të cilat takime iu janë bashkangjitur gjithashtu dhe gratë udhëheqëse të grupeve të grave përfituese. Ato kanë marrë pjesë rregullisht por me rotacion në çdo të dytin takim, dhe kështu që të gjitha udhëheqet e grupeve janë njohur me aktivitetet e RRGK dhe janë socializuar me gra të tjera.



***Gratë e MGJ dhe të DeD takohen me gra të OJQ-ve tjera – anëtare të RRGK***

Edhe pse janë bërë shumë përpjekje për të aspektit avokuar në kuadër të aktiviteteve të përbashkëta të anëtareve të RRGK për të adresuar statusin e të drejtave të të mbijetuarave të dhunes seksuale gjatë luftes në Kosovë shume më heret, bile menjëherë pas përfundi mitt ë luftes, gjatë vitit të fundit të periudhes implementuese të këtijë projekti , kjo qështje u adresua nëpërmjet një proteste në nivel kombëtar. Ajo u organizua nga RRGK, me 8 mars me moton: “Ne nuk duam lule, duam drejtësi për të mbijetuarat e dhunës seksuale gjatë luftes”. Në këtë protest, përveq stafit të MGJ kanë marrë pjesë edhe disa kliente. Qëllimi i protestës ishte sigurimi i njojes juridike dhe publike i statusit të të mbijetuarave të dhunes dhe kompenzimi i tyre duke amanduar ligjin i cili do të ju ofronte kompenzim, dhe / ose benefite të tjera. Protesta pati ndikim të madh në mobilizimin e institucioneve që me seriozitet të marrin përgjegjësinë për përkrahjen e grave viktime të luftës dhe për të drejtat e tyre në trajtim të njetë si kategoritë tjera të luftës. Të njejtën ditë u mbledh parlamenti dhe përbiluan një rezolutë për përkrahjen e qasjes së të mbijetuarave në drejtësi dhe mbi draftimin e ligjit që do të ju siguronte beneficione të njehta me veteranët, invalidët dhe viktimat civile të luftës.

**Sfidat dhe vështirësitë:**

Gjatë implementimit të projektit MGJ është fallafaquar me disa sfida dhe vështirësi:

- Sfida më e madhe në periudhën fillestare të implementimit të projektit ishte themelimi i një OJQ të re, me qëllim të vazhdimit të përkrahjes së grave që iu bashknagjitën personelit profesional të MGJ pas ndarjes. Por kjo sfidë u tejkalua duke punuar nën ombrellen e shoqatës RENESANCA – një organizatë e regjistruar. Gjatë muajve të parë, personeli arrijti që të themelon dhe të regjistron OJQ-në e vet, dhe më pastaj ndërtoan strukturat e organizatës dhe rregulloren e punes.
- Sfidë tjetër ishte dhe bindja e grave fermere që të themelojnë dhe regjistrojnë kooperativën e grave. Gratë që vijnë nga zonat rurale akoma nuk janë të mësuar që të punojnë së bashku si grup i organizuar.
- Një vështirësi, e cila në shiqim të parë nuk dukej ashtu ishte dhe mbledhja e ofertave për pajisjet për kooperativen e grave / shitoren dhe aumjeteve (të ashtuquajtura të dorës së dytë). Nëse dëshironi të bleni automobile të përdorur në Kosovë, meqenëse shiten në treg të hapur, është e vështirë të sigurosh oferta.

Qëndrueshmeria e organizatës pas implementimit të këtijë projekti ishte sfida e radhës, por u tejkalua pasi arrijtëm të sigurojmë një trajnuese – eksperte për ngritje të fondeve. Ky trajnim ndihmoi anëtarët e grupit udhëheqës që të shkruajnë dhe dorëzojnë project propozime tek donator të ndryshëm.

**Reportoi: Selamet Peni /Drejtoreshë**

**Donatorët e Medica Gjakova gjatë kësajë periudhe raportuese**



Bundesministerium für  
wirtschaftliche Zusammenarbeit  
und Entwicklung



**Donacionet mund të dërgohe në:**

**ProCredit Bank-Gjakovë**

1140163861000154

**Kontakti:**

**SHOQATA E GRAVE MEDICA GJAKOVA**

**Adresa: Str. Fadil Nimani Nr. 34,**

**50000 Gjakovë/Kosovë**

**Web: [http:// www.medicagjakova.org](http://www.medicagjakova.org)**

**Email: [medica.gjakova@hotmail.com](mailto:medica.gjakova@hotmail.com)**

**Tel: +381 0390 326 812 Fax: +381 0390 326 812**